

Mbi koncertin për violinë dhe orkestër (redaktimi për violinë dhe piano) të kompozitorit Vasil S. Tole

Partitura muzikore më e fundit e shkruar nga kompozitori Vasil S. Tole, është koncerti për violinë dhe orkestër (redaktimi për violinë dhe piano), i cili paraqitet në këtë publikim.

Edhe më herët autori i ka qëndruar afër instrumentit të violinës, duke shkruar paraprakisht edhe vepra të tjera për këtë instrument, si “Sonatë” për violinë e piano; “Suitë” për violinë e piano; “Alla shqiptarçe” për violinë solo; “Trio” për harqe (violinë, viola e violonçel); “Dda”- kuartet harqesh, si dhe disa vepra për orkestër harqesh si: “Rondo”, “Valle antike”, “A Psalmodiae Bono” e të tjera punime për këtë instrument, magjinë e të cilit ai e njohu që në vogëli.

Koncerti që kemi në dorë është shkruar në formën e sonatës dhe ka strukturë njëkohëshe me kadencë. Me një kohëzgjatje interpretimi prej rreth 38 minutash, vepra ka ngarkesë ideore dhe teknike të lartë si për solistin, ashtu edhe për dirigjentin e orkestrën. Kjo për shkak të gjuhës muzikore, teknikës së avancuar instrumentale, si dhe përdorimit të ritmikave që hasen në faqet e këtij koncerti.

Vepra ka frymë thellësisht kombëtare, qoftë për nga individualiteti i kompozitorit, ashtu edhe nga atmosfera intonative që ajo përshkon. Pikërisht intonacionet e kabasë në hyrjen e veprës, të paraqitura nga violina soliste (masat 1-43), janë ato që i japin tonin asaj përmes intervaleve me “të qarë” e rrëshqitjeve tipike të kësaj gjinie tradicionale, të ndërthurura me elementet përfaqësuese të kabasë, hedhësit e prerësit toskë. Flladi që ndihet që në fillim është ai i pentatonikës së Jugut shqiptar, i gërshetuar me vallet tradicionale po të kësaj krahine. Në vazhdim të partit hyrës (germa A, masat 45-61) fjalën e merr pianoja (orkestra), që në mënyrë pak më dinamike e një tingëllim disi solemn, duket sikur kërkon vëmendjen e dëgjuesit për të na çuar te tema kryesore.

Tema kryesore (germa B, masat 61-85) është një melodi e qartë me karakter afirmativ (pohues). Parti i violinës shpaloset që në fillim i zhdërvjellët, shprehës e depërtues e duke mbajtur gjallë atmosferën e ndezur të kësaj teme dinamike, në të cilën mbizotëron atmosfera e valles tradicionale. Kjo temë, që në ekspozicion merr një zhvillim të gjerë dhe krijon ndjesinë e një ngarkese dramaturgjike, e cila pas disa faqesh partiture, shkarkon apo lëshohet në lirizmin tingëllor të temës së dytë.

Parti sekondar (germa J, masat 299-323), është një melodi lirike e qetë dhe e këndueshme falë shtjellimit melodik që e karakterizon. Duke qenë gjithnjë nën pushtetin e atmosferës modale të Jugut shqiptar, si dhe melodicitetit sa emocional aq dhe shprehës, kjo temë i krijon mundësi solistit të shprehet më së bukuri me kantilenen e tij dallgëzuese. Melodia evokon ndjenjë nostalgjie apo dhe refleksioni, ndoshta, për ngjarje që i kanë lënë mbresë autorit në qenien e tij. Tema shtrihet krejt natyrshëm në tërësinë strukturore të veprës. Parti i violinës bëhet gjithnjë e më shprehës, gjë që i lejon solistit të shpalosë vetitë e tij muzikore, apo më mirë aftësinë e tij për t’u shprehur më së miri muzikalisht.

Pas këtij momenti qetësie e kantilene të brishtë që sjell tema e dytë me të cilën mbyllet ekspozicioni, vjen faza e përpunimit (germa M, masat 399-696). Këtu rikthehet dinamizmi tingëllor i temës së parë, këtë radhë edhe më elokuent e më i sofistikuar. Parti i pianos (orkestrës) vjen akoma më i zhvilluar, të cilit i bashkohet edhe parti violinistik që bëhet gjithnjë e më i gjallë. Si fazë e dytë e përpunimit (germa N, masa 441), vjen një episod ritmik i marrë nga kënga përmetare “Kur më shkon sokakut”. Burimi i këtij metri shfaqet në organizimin ritmik 7+8+9 / 8.

Përdorimi dhe implementimi i këtij metri në koncert lidhet me nevojën që ndien autori për ta zhvilluar temën kryesore në pikëpamje dinamike si dhe për të çliruar energjinë e brendshme të saj, pasi në thelb kjo skemë ritmike, pas çdo mase shton nga një notë (lëvizje) 1/8, duke krijuar një “motorikë” të tipit “Perpetum Mobile”. Gërshetimi i kësaj teme me temën e parë sjell tensionin e nevojshëm deri në dukjen e temës së dytë, si një fazë tjetër e përpunimit (germa Q, masa 551), e cila këtu na vjen më e fuqizuar dhe më motorike krahasuar me dukjen e saj në ekspozicion. Rikthimi i vazhdueshëm i përpunimit të temave në vazhdim krijon ngarkesën e duhur për zhvillimin dramaturgjik të veprës. Dinamizimi arrin shkallën më të lartë edhe falë partit violinistik tejet virtuoz. Ndërthurja violinë–piano (orkestër) merr karakterin e një himnizimi simfonik, ku vazhdon të mbizotërojë melodika e qartë, e veshur kjo me tiparet dhe petkun tradicional kombëtar. Shoqërimi pianistik (orkestral) e justifikon më së miri funksionin e tij, duke i dhënë mundësi violinës të qëndrojë jo vetëm përmbi, por dhe të plekset me të, për të krijuar një fuzion të vërtetë simfonik. Violina dhe pianoja (orkestra) sjellin në vëmendje edhe një herë tingëllimet e vajeve të kabasë, këtë radhë në strukturën e një kadence të lirë, të zhdërvjellët dhe mjaft shprehëse nga pikëpamja e materialit muzikor.

Kadencia (germa U, masat 697-825), duke përlligjur materialin tematik i jep veprës bukuri të veçantë. E zhvilluar në formën e kabasë koncertale me një ekspresivitet të ngjyrshëm, ajo është e mbështetur në traditën më jetëgjatë të zonës së Përmetit dhe të muzikantëve si Laver Bariu me shokë. Duke e rimarrë lëndën muzikore tashmë të pashoqëruar, kombinuar kjo me teknikën virtuozë të violinës soliste dhe e pleksur me lirinë e fantazisë artistike të interpretimit, kompozitori ka mishëruar më së miri tonin tradicional të kësaj gjinie (kabasë). Kadencia ka gjerësi si në drejtim të shtjellimit të saj, ashtu edhe në drejtim të frazimeve dhe timbrikave të përfutuara, të gjitha këto në shtjellimin e një teknike të lartë dhe tepër të zhdërvjellët violinistike.

Repriza (blloku i tretë i koncertit) vjen në formën e një epilogu të zgjeruar (germa V, masat 825-1092). Rikthimi energjik i materialeve tematike, si dhe marrëdhënia mes solistit dhe pianos (orkestrës) e dinamizon akoma më shumë veprën. Duke nënvizuar karakterin melodik si dhe elementin tradicional të mbështetur në pasurinë e kulturës sonë muzikore, shfaqen herë pas here edhe momente të një fantazie kabaistike apo tingëllime trillesh të goditura. Vepra i drejtohet fundit me një kaleidoskop ngjyrash muzikore e mjetesh teknike shprehëse, gjë që e bën atë të tingëllojë mbi të gjitha të këndueshme, herë me tone meditative e herë pasionante.

Codetta (masat 1093-1145), e ndërtuar mbi materialin tematik kryesor të koncertit, në të cilin mbizotëron këndueshmëria, me pasazhet violinistike të mbështetura edhe nga dendësia shoqëruese e pianos (orkestrës) të shpien drejt mbylljes së koncertit si një pohim final i përforcuar.

Përgatitur nga prof. Lorenc Radovani

Tiranë, shtator 2023